

STEFAN MARTIKO

NË MOSHËN E
ABELIT

- POEZI -

Tiranë 2020



Autori: Stefan Martiko
Titull: Në moshën e Abelit
Redaktor: Josif Papagjoni
ISBN:

Copiright: Autori

Faqosja: Mimoza Vasku

Botimet



Rruça "Him Kolli". Pallati nr.41. Kati Nëntokë. Tiranë. Albania
E-mail: shtyp.emal@yahoo.com
Tel: 00355.682.036.631

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Akujt.....	7
Dënimi.....	8
Shënime për motin.....	9
Varri bosh i atlantidës.....	10
Peng mërzie.....	11
Njeriu pa pedestal.....	12
Trishtim kozmik.....	13
Njerëz dhe mite.....	14
Më parë qe drita.....	15
Një burrë.....	16
Zëri i lutjes.....	17
Ka pak kohë.....	18
Kaproll i verbuar prej brirëve.....	19
Unë dhe deti.....	20
Amadeus.....	21
Lumë i trazuar.....	22
Pa gjak.....	23
Afër mesditës.....	24
Relike.....	25
Rreh zemra.....	26
Të fshehtat.....	27
Pasqyra armike.....	28
Çfarë jam duke parë.....	29
Drita e shpirtrave.....	30
Kujtesë e vdekur.....	31

Hapi i dytë i kujtesës.....	32
Shërbesat.....	33
Ku ta çoj udhën.....	34
Ajkuna.....	35
Në prag.....	36
Kamikaze.....	37
Mësues i vetes.....	38
Në moshën e Abelit.....	39
Kronika e mbrëmjes.....	40
Zjarre të shuar.....	41
Metafizike.....	42
Gabime të pafajshëm.....	43
Ndjenjë.....	44
Lola.....	45
Eshtrat e gjuhës.....	46
Kavje eksperimenti.....	47
Në zgrip të gropës.....	48
Kjo qarje kozmike.....	49
Një burrë.....	50
Pezull.....	51
Loja e së përjetshmes.....	52
Vdekja e krimit.....	53
Mërzi ishullore.....	54
Nesër.....	55
Arka e Noes.....	56
Shpirti rri fshehur.....	57
Gjuhë ezopike.....	58
E qeshura zbavitëse.....	59
Nën kupolë të resë atomike.....	60
Shndërrimi i madh.....	61
Në ishull.....	62

1991.....	63
Morali.....	64
Duro kujtesë dhimbjen time.....	65
Rrugicë e mbyllur.....	66
Fëmijtë.....	67
Kandinski.....	68
Rritje.....	69
Cunami me emrin Irenë.....	70
Pushtues të rinj.....	71
Era merr gjethet me vete.....	73
Ajër i lirë.....	74
Të rrahurat e gabimit.....	75
Njerëz të egër.....	76
Lojëra tragjike.....	77
Heshtja në park.....	78
Lëkura e fjalëve.....	80
Kundërhelmi.....	81
Sizifë të një kohe tjetër.....	82
Diagramë.....	83
Ajo që përherë është duke ardhur.....	84
Në gjyqin e së ardhmes.....	85
Balonat në zemër.....	86
Përralla me ujqër e keca.....	87
Alkimisti.....	88
Në treg.....	89
Ritëm shiu.....	90
Betohem.....	91
Turma një-këmbëshe.....	92
Lexim i vështirë.....	93
Megjithatë.....	94
Tokë edhe qiell.....	95

Zjarri dhe hiri.....	96
Zoti i përfytyrimit.....	97
Fjala është zoti.....	98
Rojet e frikës.....	99
Shpirti i shkretëtirës.....	100
Gjaku i fjalëve.....	101
Në Koqino Milo.....	102
Gërmadhë e bukur.....	103
Opium	104
Nëpër stinë.....	105
Në udhëkryq.....	106

AKUJT

Dalëngadalë po tretet
kjo borë që e pinë të
eturit. Dhe këta male prej
akulli. Pas terjes së mjegullës
u zhduk dhe misteri. Pesha
mbi vete më ka shtypur
te udhët për tu tretur. Ç' ishte
do ta gjejmë te
harresa nëse ajo na dorëzon
çelësat. Këtu te ish -Greonlanda
s' do gjejmë as eshtra
të akujve. Çfarë kishte qënë
në vdekjen e saj
po tretet.
13.3.16

DËNIMI

Një fëmijë është një
lojë e bukur për të lozur
Prej lojës do vijnë mësimet
e hidhur. Do thyhen këmbët
e të qarat do pijnë lotët e
vetë të kripur. Fëmija i kap
marrëzitë e lojës me dorë dhe
ne qeshim. Por një fëmijë në të
vërtet nuk luan përveçse si dënim
ngjitet në skenë
për tu rritur
20.3.16

SHËNIME PËR MOTIN

Përherë kam shpresuar në atë
që e dija se kurrë s'do të
vinte. Shënime për motin kam
mbajtur kam bërë skica të
shumta me një njeri që majës
së një mali i ngjitej. Por asnjëherë
s'isha unë por një tjetër. Unë isha
mbrapa në një tra ekuilibri në
ajër. Një vështrim që stërviste
gjymtyrët e njeriut që lëkundej
Shpresa e tij isha unë dhe
ai në dorën time vetëm
një flamur i zhubrosur
27.1.09

VARRI BOSH I ATLANTIDËS

Kudo ka gjurmë edhe nëse pemën
e shkulim nga rrënjët. Varri bosh i një
Atlantide të humbur. Ne
që para ecim vetëm ato për t'i
gjetur. Ky është kalvari i mundimshëm
stafetat japin e marrin çukisin
vezë të të ardhmeve të tjera. Për të
zbuluar Atlantidën- një jetë
e vetme nuk mjafton dhe ato njëra-
tjetrën e lindin. Gjurmët nuk ndodhen
më në të shkuarën. Atlantida na pret
përpara. Zogu rritet duke fluturuar dhe
njeriu sheh edhe më shumë
ëndrra
27.1.09

PENG MËRZIE

Duhet të gjëmosh përherë si
mundësi shiu. Të mos ikësh
prej vëmendjes dhe përherë të jesh
i trembur prej frikës. Jo njëherë në një
shekull por të ndiehesh
si kujtesë e eshtrave të thyera
në qiell. Kërko ndihmën e tërë zotave
por pranvera në tokë
do të jetë mungesë e përhershme
dhe peng i një mërzie
17.5.09

NJERIU PA PIEDESTAL

E pash më vonë po s'qe më
ajo apo unë s'isha më
unë. Koha e mungesës e kish
flakur kujtesën në lumë. Pash
aty një tjetër që më ngjante aq
pak dhe ato lule në duar
si eshtra plaku ishin
tharë. Ajo si piedestali im
qe ulur më tepër sikur
një të gjallë ta kish zënë gjumi
mbi një të vdekur

22.2.09

TRISHTIM KOZMIK

Një fytyrë e vuajtur ende
s'është pastruar. Hije që
mbeten. Bëhet një palimpsest
që do të lexohet jo sot por
nesër. Në këtë tokë s'do të
dimë kurrë çfarë në të për
herë të parë ishte mbjellur por
epoka është çarë dhe përmes
së çarës do të lexohet. Dyshimi që
më në fund së ardhmes do
t'i jepet prej një të shkuare
tjetër. Mona Liza iku më larg dhe
trishtimi kozmik kurrë nuk të retushohet

8.7.09

NJERËZ DHE MITE

Me të sapo u ndava. U ndamë të dy përgjymë. Gjysmën time e lash tek gjysma e asaj që iku dhe unë në gjysmën e asaj po shndërrohem në një lloj centauri. Zemra ime në një trup tjetër çfarë i thotë asaj duke ecur. Unë në lumë të gjakut të saj nis për lundrim gjysmën tjetër. Mite të lashtë ju jini njerëz të gjallë të montuar prej pjesëve-dashuri dhe urrejtje. Unë minotauri njeriu dhe demi dhe ti sirenë e bukur me bishtin e një peshku që kur të vdesësh do të jetosh te një tjetër.

27.1.09

MË PARË QE DRITA

Drita ma dhuron vështrimin
dhe sytë vetëm çelës
i saj që e hapin dhe
mbyllin. Më parë që drita
e pas saj sytë u shpikën. Syri
i lindur prej dritës kur s'kish
më natë vetëm. Dhe ajo që
sulmon dyndet e tëra
njëherësh. Në shkrepëtimat e patkonjve
të kuajve pishtari im është
ndezur
15.1.07

NJË BURRË

Një burrë del nga shtëpia
me një dhimbje në shpatull.
Me një re të vogël mbi supe. Pak
më përpara ka pastruar prej
syve mjegullën për të
zbërthyer shenjat që
horizonti i ka fshehur
me mjegull. Ky burrë
e di sa e rëndë do të jetë
pesha në të kthyer. Dhe mba
një makinë llogaritëse me
vete. Ca do t'i lerë si
gjurmë udhës ca do
t'i sjellë në shtëpi
dhe ca të tjera do t'i ruaj
te kujtesa mbyllur me çelës
12.2.17

ZËRI I LUTJES

Mënyra si lutet është
zëri i vuajtjes nga
brenda. Dhe më shumë se
sa lutje këtu dëgjohet klithma
e fuqive të humbura. Por
çfarë është e fshehta gojëmbyllur
e kyçur nga brenda. Ajo
që s'artikulon dot veten prej
frikës mos shpërbëhet
e tëra.
5.2.17

KA PAK KOHË

Ka pak kohë
sa ka mbetur prej këtij
vrapi që nuk e arriti dot
kohën. Ti sheh vetëm
akrepat e çmendur që
vrapojnë të nxjerrin
jashtë logjikës
vet kohën
5.2.17

KAPROLL I VERBUAR PREJ BRIRËVE

Me vrap drejt një hijeje
kaproll i bukur i verbuar
prej brirëve çfarë sheh
tani janë avujt e ngrohtë
të frymës që shkëndijojnë
duke ndezur flakë përtej
atyre shkëmbinjve
Qetësi që mund ta kisha
pikturuar dhe ndryshe
po ta kisha mbuluar kaprollin
të tërin me hije
15.7.16

UNË DHE DETI

Këtu unë jam kufiri
i detit. E detyroj të laj
Këmbët e mia pasi më parë
ka pastruar veten duke lënë
në breg të mbyturit. Unë
jam ndajshtesë e tij
për tu bërë bota që sjellë
këtu vathdimisht lajme
dhe ikën. Siç u pasqyrova
tek ty kaq e kaq kohë
pastaj ti në kujtesën time
ishe mbytur. Në kufi veç
gjëra të tilla ndodhin
për t'i lënë fajet dhe pa
pendesën të shkosh
për tek krimi tjetër
22.5.16

AMADEUS

Kudo ka një shtëpi Amadeus
mes kopshtijeve dhe
fshehtësisë ku mbijnë farëra
të Moxartit të vogël. Ca tinguj
valë-valë vijnë
prej dy shekujve. Kalo në
heshtje nën këtë kurorë
tingujsh. Në dalje të një
tuneli sapo ke parë dritën. Të
trembur paksa nga përjetësia
e takimit me
Amadeusin e vogël. Zoti
që kishe besuar jo më
në qiell është duke e
pritur te porta
19.9.16

LUMË I TRAZUAR

Në kohën e trazirave
kur s'di për ku po vrapon
lumi. Asnjë lumi nuk i
pëlqen ky shtrat i ngushtë
ujërash. Kur ende s'di prej
nga ka ardhur e gënjen shtratin
nga anët por lufta ka nisur
nga brenda. S'di çfarë del
tepër e çfarë nuk është shkullur
ende prej rrënjëve
19.2.16

PA GJAK

Më e thellë u bë shprehja
kur fryn mbi bar fladi
përkulja që ngre krye pas pak
me një lutje. Fjalët si mungesë
me tyrjela i shponin të shpërthenin
nga brenda. Po çfarë në të
vërtet është duke ndodhur
me gjuhën në këtë vallzim
tingujsh. Një natyrë pa
mendje tani si balerinë
po argëton njeriun
19.2.16

AFËR MESDITËS

Gjer në mesditë
as gjysmën e mungesës nuk
e ushqeva dot me frymën
time. Duke vrapuar më
shumë kisha nxjerrë djersë
të pista. Aty nga ora
11:00 zbulova shkakun e
vonesës dhe korigjoja një
nga një gabimet duke i
shkulur si gjëmbe. Por
nuk po matja dot
perspektivën dhe nuk
pash asnjë që të
mbërrinte. Atëherë njoha
natyrën e gabimit dhe më
duhet të korigjoj mendjemadhësinë
e Çezarit. Afër mesditës
mbi krye mu bë një re
e madhe. Atëherë u tremba
se mos çdo gjurmë timen
do ta lante shiu
1.6.16

RELIKE

Shoh këmbët për të
matur udhët dhe majat
e këpucëve të grisura. Patkonjtë
mbi thundrat. Gjithçka
është gjurmë që ne i lamë
udhës. Tani po blej
si relike tërë këpucët
e mia skarpinjat dhe pandoflat
e një foshnje të porsalindur. Çdo dyshim
e ka tokën nga e djathta dhe në
rreziqet e tjerë mund të shohësh
thellësinë e greminave
15.7.16

RREH ZEMRA

Numëroj 26 sekondat
sa e zhvesha
të veshurën. Ankthi në rritje
çfarë do të shoh nga brenda
Kohë nën torturë e një
vrasësi që po vret
dëshirën. Përtej e këtej
kohës që më vonë bëhet
e panumërueshme. 26
rrahje në përjetësinë e
saj të një zemre
15.7.16

TË FSHEHTAT

Më tej është e fshehta
tjetër. Një sondë që
shfryn e tërbohet. Shumë
janë të fshehtat. Nuk e
zbuluam dot çerdhen
ku ajo ngrohte
vezët. Shumë vonë
në mërzitje e
gjeta veten duke
fjetur te shpella
13.7.16

PASQYRA ARMIKE

Nëpër damarët e mi rrjedhë
gjaku. Dëgjoj fëshfërimën por
ç'shoh jashtë hynë
brenda ku çdo hap më bëhet
rrjedhë e gjakut. Që
prej kohës së lulëzimit të
parë në rrudha bie dritë
e së qeshurës. S'jam ai që
kam qënë dhe që s'do
të jem ai që tani është të cilin
nuk e njeh më as pasqyra

1.2.16

ÇFARË JAM DUKE PARË

Ç'kam qënë më është një ofshamë
ose përshpërimë një mërmërimë
ose cicërima. Për të zbutur
ulërimat. Afrojuni bubullimave
prej flakëve të Zeusit. Një flad
që prek gjethet e gjethet zbulojnë
zogjtë që mbajnë fshehur. Gjer
sa të bjerë drita e parë e agimit. Shoh
gjer në cepin më të largët
errësirën gjer te bregu im
lëmshe zjarri e flake
që flijëzohen gjer sa të
këputen si jargë
prej gojës së egërsirave
5.2.16

DRITA E SHPIRTRAVE

Fletët hanë gërmat. Bëj dhe unë
një provë të ushqej një përbindësh
Që prej Homerit letra ka ngrënë
tërë pyjet. Kujtimi i pemëve
është shkrimi. Te grykë e furrës
jap dëshminë time. Letra nxjerrë
shpirtra në dritë të trupave
të tyre që digjen
20.12.16

KUJTESË E VDEKUR

Ky vend si
i vizatuar për
tu fshirë më vonë
nga kujtesa. Kaq
përrallor sa unë
habitem që po
shoh tërë rrëkerat
që gurgullojnë poshtë
pa parë ende lumin
Ky vend ndoshta
s'ka ekzistuar asgjëkundi
por unë e pash
në një ëndërr si të
kish qënë vendlindja
ime për të cilën
unë shkrova diçka
vetëm kur ajo
kish vdekur në
kujtesën time
21.3.15

HAPI I DYTË I KUJTESËS

Më duhet të shtyp
një mijë butona për
të çuar kujtesën tek
shpella. Njëri buton që
shtyp tjetrin e nxjerrë prej
arkivit të saj me një
shpejtësi marramendëse
Sa e sa shumë butona
sisteme që e venë në
mendjen time për të
nxjerrë më pas ca skelete
të fishkur dhe ca
relike që dorë pas
dore shiteshin për të rritur
vlerën e tyre të shitjes
22.8.15

SHËRBESAT

Ne të gjallët
do përgjigjemi edhe për
gabimet e të vdekurve
Jemi bashkuar e ndarë por
të pleksur nëpër rrënjë të
hidhura. Bashkë
jetojmë edhe në faqet e
këtij libri. Te fryma
që thithim. Ne përherë vijmë
prej atyre luftrave
ku ata i patën
humbur. Kryejmë shërbesa
për ta dhe u fshijmë me
gjuhë mermerët. Asnjë
nuk mungon përndryshe
unë s'do isha i
fundit në këtë rend
që pret radhën
pas porte
29/8.15

KU TA ÇOJ UDHËN

Po shkoj të
gjej një hap tjetër prej
rrugës që s'më çoi
asgjëkundi. Kam një vete të
mërzitur me veten dhe
s'di
ku ta shpie. Por jam i
vendosur ta shkul prej udhës
të mbushur me njerëz që
po e shtyjnë për ta çuar
te Meka. Unë që e mba
tani mbi shpinë krejt udhën
as zoti im s'më thotë
dot ku ta shpie
30.8.15

AJKUNA

Sa hap portën
një duhmë ere dhe
ajri të ngjeshur që më
ze frymën. Është fryma
ime e vjetër që po
ushqen barin te
rrënjët
Po ia sjell të
ardhmen e saj për të
ngushëlluar të shkuarën. Si Ajkunë
ajo e ka nxjerrë gjirin
e bardhë për të ushqyer
ata që kthehen. Ata që
vijjnë këtu vetëm
për të vdekur
4.4.16

NË PRAG

Duhet një pastrim së pari
duke e zhveshur për të
mbërritur tek virgjëria
që e veshën për ta shitur
në treg për të ndershme
Poezia ende nuk
ka zbuluar veten ku
ndodhet. Pa e prekur
tek ky tel ku nisin
dridhërimat e tokës
në prag të
tërmetit
6.4.16

KAMIKAZE

Kam dal në treg për
tu shitur. Nuk
jam krejt unë
por një pjesëz e imja
e përveçme që i jep
emrin e vet
së tërës. Tregu
është i gjallë përherë
në prag të një
çmendurie të cilën nuk
po e zbres dot nga
reklamat në qiell
ku shpirti im si
kamikaze po digjet
6.4.16

MËSUES I VETES

Tërë ditën i rrethuar nga miti
më duhet të hap tunelin
nën vete. Këtij mashtrimi
të madh verbues me
premtime boshe t'i ngre
dhe unë kurthin në
mendjen time të vogël
të shfletoj enciklopeditë e
botës. Të bëhem mësues
i vetes që ka në metodën e
vet gënjeshtrenë dhe të
citoj përherë stoikët që
fatin e përkëdhelin e
nuk ia thyenin me vare atë
guaskë të përbindshme

1.2.06

NË MOSHËN E ABELIT

E di që jam i vjetër
me moshën time në xhepat
e kujtesës. Një lloj dragoi më
ka kapur dhe fëmija huk
nxjerrë dot këmbët nga
pelenat. Po të kisha mendje
Abeli as që do ta kujtoja
më as nënën që më kish lindur.
Aty rreth vitit 800 të lindjes kisha
bërë dyqind martesë të tjera. Prej
flokëve të paprerë të Abelit
Ararati i tërë që fshehur nën
mjegull. Por unë qethem e
grisem sepse luftoj brenda
vetes. Fantazinë e përdor
si krehër për mjegullat e
Abelit. Dhe sa më tepër rri
me shpirtin tim zgjuar
mosha ime po kap atë
të Abelit.

1.10.16

KRONIKA E MBRËMJES

Shiko si jam veshur palombar
që në rrugë kërkoj për tu
mbytur. Më tepër gjendje
masë lënde e shpirti
tjetër dhe fare pak mendime
që t'i shkarkojnë peshat për t'i
vënë në lëvizje
Nxirr e nxirr të mbytur nga
deti me të cilët u mbushën
kronikat e mbrëmjes. Ata me
veshje palombari
të modës së fundit
Me rripat e saj të lidhur
e mbajnë në gjendje gatishmërie
të përhershme trupin
2016

ZJARRE TË SHUAR

Prej afshit erdhi të asaj
që së largu po digjej. Do të
qe Troja nën flakët e
zjarreve të shuar. S'kish më
të vdekur dhe qe pastruar
kujtesa prej tyre. Fjalët po
ato një materje e shuar
Duhma e frymëve shtyp ajrin
dhe tani dalin fantazmat
në kërkim të trupave të tyre
31.3.06

METAFIZIKE

Ruga pothuaj nuk ka më
njerëz. I këputën fjetet dhe
hynë në një qark tjetër. Ndoshta
tani në koshere po flejnë
tërë bletët një gjumë
misterioz që kurrë s'ka për
ta mësuar peshën e metafizikës
së një truri të vogël
11.4.08

GABIME TË PAFAJSHËM

Jam përherë plus gabimet një
inventar i ngjeshur imtësirash
ku njëri shkak ia mbyll
arsyen tjetrit. Gabimet krejt të
pafajshëm tani rrinë të
mërzitur dhe kërkojnë
falje sikur aty rastësisht
të qenë ndodhur. Por asnjëherë
nuk u parashikuan ndonëse
prej vemjeve të tyre po
dilnin ca krimba. Më vonë ata
u bënë flutura që ia lehtësojnë
barrën historisë
për t'i shkruar
11.4.08

NDJENJË

Po ta bashkoj këtë ndjenjë
me një tjetër ora nuk do
tregojë më vetëm kohën
Shumë shpejtësi njëherësh
të mendjes të këmbëve të
detit që po mbyt veten. Përtej
kohës ndoshta ka diçka
tjetër që pritet të zbulohet
Një ndjenjë është një relief i
thyer ku zbret një
humnerë e pafundme por
dhe një litar i hedhur që s'është
më kohë por ajo mungon
nga që ne s'dimë
ende si ta quajmë
12.4.08

LOLA

Po deshe mund të nisesh prej ditës
sime të nisjes kur nën një vello të
purpurt reshë po shugurohej një
nuse. E quanin Lola. Njëlloj
si tërë zanafillat por vdekjes
së saj i dhash tërë shpirtin në
këtë poezi të mbetej e
pavdekshme. Për aq sa zotëroja
nga pronat e mia
unë e rrita filizën e saj në
vendlindjen time ende të
paeksploruar. Atje ku kish filluar
ndërtimi i një qyteti të ardhëm
që edhe sot qanë
mbi rrënojat e së shkuarës
12.4.08

ESHTRAT E GJUHËS

U bëmë më konkretë ndërsa po
kërkonim. Një e ardhme si disketë
e vjetër nuk hynë më në
kompjuter. Dhe zoti na pa e
na dëgjoji si po i nxirrnim
duke qeshur eshtrat e bardha
të gjuhës. Një tabelë ogurzezë
në hyrje i ndalonte krejt
ëndrrat. Thamë të ishim ata
që këtë çast jemi si të ushqenim
me gjumin tonë bimët që
ranë në përjetësi për
të fjetur
15.4.08

KAVJE EKSPERIMENTI

Jo krejtësisht hapur as i
tëri i mbyllur. Le hapur një
dritare për të mbyllur tërë
dyert. Sepse dhe fryma
prishet brenda fjalëve të
përsëritura dhe vështrimeve që
pasi të kanë rjepur lëkurën tani
por të hanë dhe
mishin. Hapja që duhet
mbyllur sepse arsyet po
shteren dhe mua tani do më
duhet ta mbyll si kavje
në eksperiment veten

23.5.08

NË ZGRIP TË GROPËS

Nuk ka problem të një
tjetri pa qënë më parë dhe
i yti. Si kërcënim ai vërtiti
në ajër shkopin. Përvoja s'e
ka hapur derën por vetëm sa
ka trokitur. Tërmeti i fundit
na tërhoqi pas brranazi. Në
zgrip të gropës së hapur
lajmi u bë i të gjithëve
Ndërton edhe më mirë
shtëpi të lehta konstrukte që
përkulen nga era por
kanë një elasticitet
të çuditshëm. Hyni në to dhe mos
flini gjumë pa vënë
në alarm orët me zile
Bëni të ardhme por
ta kenë sa më afër
perspektivën
18.5.08

KJO QARJE KOZMIKE

Nuk i dua çmendurisht sendet
se dhe vrapi im mbi kalë u
bë pluhur. Zilja u këput nga
qafa dhe prej galopit të kalit ca
tinguj si sërma u groposën
në kujtesën time. Sendet ikën
prej meje edhe kur hingëllima e
kalit u dëgjua si lutje. Të tëra
shkërmoqen që nga sëpata prej
guri e mprehur te mishi im
të cilin e grinte. Anija Andover shkon
e vjen nëpër qiej të largët sendi ku
ne flejmë brenda po i zbërthehen
vidat në qiell si hingëllima
kali dhe u dëgjua kjo
qarje kozmike

17.5.08

NJË BURRË

Një burrë këndon nën
shi si zog. Kot ia nisi për t'i
hapur udhë fjalës. Një njeri
është sfidë - bir i një miti të
lashtë që e zuri nata në
udhë. Kënga thotë diçka për
perëndimin për hijet që
vijjnë për lëmshe zjarri që
shpërthejnë prej tërë shqisave. Një
burrë këndon nën shi i tëri një
harpë me tela- rëshekë të
shiut. Tani ve në
punë zemrën jo duart. As kujtohet
të kërkojë çka humbur. E le
veten të lirë në dorë të
natyrës. Tani burri po qa
me pika gjaku te buzët. Do
vijë çasti i mëshirës së madhe
kthimi i heshtur te zoti. Mbushja
e maternitetit me të
sapolindur.

13.1.09

PEZULL

Një herë kur mbeta pezull nëpër
ura të larta në kryqëzim të
shumë udhëve dhe shumë
shpejtësive. Të zbrisja në tokë
por s'kish njeri për të
pyetur. Mbeta pa kohë dhe
hapësira brenda saj më
s'do të shkruhet. Aq
lart sa shpejtësitë te ura
përplaseshin duke
ulëritur. Si në një kohë të shkuar
po dëgjoja një përrallë se
në botë më vonë do jetonin
vetëm njerëz të çmendur. Urat
po më kapnin por përralla
nuk ka mbërritur ende tek
urat ku unë lëkundem duke
rënë nga një prehër në tjetrin
17.4.09

LOJA E SË PËRJETSHMES

Ah ti miku im
siç më erdhi kjo fjalë
më duhet ta shkruaj
Një fjalë që përmban tërë
mungesën tënde. Në atë dhe
përherë të lagur ku njehsohemi
Ç'po bën atje në atë gjë të
ku më së fundmi po
prehen këmbët nga lodhja
e udhës. Sa ishim lodhur
me lojën e së përjetshmes
ku hynim në varr të lumtur
e delnim prej andej të
mërzitur. Siç e patëm thënë
nëse kujton miku im në
atë grimcë kohe që s'arritëm
t'i thoshim të gjitha. S'ishte
asgjë ajo që thamë kur e pathënë
një çast do mbetej e
tëra. Çështje tabu u bë vet
koha që jetonim për të shpjeguar
një ekzistencë aq jetëshkurtër
29.5.09

VDEKJA E KRIMIT

Krimi përpiqet ta fsheh
shëmtinë kur është kryer i
ka thyer tërë pasqyrat që
e kanë parë. Ka vrapuar
më tepër se koha ka humbur
në terr për një vit a dy
dhe i ka mbirë leshi në trup
Ne e takojmë në rrugë
dhe e pyesim mos e ka
parë një krim që i pandëshkuar
nëpër viset tona po
endet. Ai buzëqesh dhe
thotë se krimit gjer te
vdekja dhe pak kohë
i ka mbetur
2.6.09

MËRZI ISHULLORE

Kam zënë radhë te këto radhë
të pafundme që çojnë
gjuetarë të vrasin
mërzinë nëpër ishuj. Ah
sikur të ringjalleshin sapo
në një nga ishujt të kishin
mbërritur dhe të shpalleshim
Kolombër. Oh unë e kam mërzë
radhën që më le pas të tjerëve
të avionëve që prishen në
qiell të anijeve që iu tremben
aisbergve të makinave që
përgjithësisht kanë mendjen time
dhe çmenduria nuk e pret
më arsyen që pasi e ka shtypur
në hiçin e madh
për vete ka fluturuar

20.12.07

NESËR

Nesër këtë pamje do ta
vizatoj ndryshe do t'i shtoj pak më
tepër kujtesë ku tërë bojërat që
kam në fantazinë time do të
shkrihen. Sa për nisje unë të
dhashë besën e rrugës se mbi
shpinë edhe të vdekur do
të ngrija duke të shkukur nga
dhëmbët e ujqërve. Por përherë
këto ndodhin më vonë pas aktit
ta parë ku Hamleti ende në
skenë nuk po duket dhe vrasësit
janë miq të mirë e të
vizatuar në mënyrë të tillë
që më vonë me gomë
edhe mund të fshihen

7.12.07

ARKA E NOES

U dëgjoja zërat që herët që kur
më tregoi nëna të fshehtë e
gjuhës së tyre. U lodha që tu ve
fre dhe nënës i thoshja unë
e shoh zërin tim ku mbytet
Ajo më qetësonte në prehër por
nata bëhet pronë e çdo
njeriu dhe nga gjithësia shkëputet
thërmijë e saj apo ylli më i largët.
Këtu ndërpritej
bashkëbisedimi me nënën ndërsa
unë qaja nëpër vetmi të mëdha
dhe ajo përkundte djepin tim
si Arkën e Noes
8.1.08

SHPIRTI RRI FSHEHUR

Prek gotën me buzë dhe
i shpëtoj metafizikës që u bë
avull i pijes që gota
mban brenda. Ti shpirti
im që brenda trupit tim
je fshehur mos më je zemëruar
që i ndërpremë bisedat dhe
po ngrejmë shtëpinë tënde
të re prej fryme e
rreze dielli. Po trupi im i
gjorë që s'fle dot në këtë
shtëpi akulli
ti mos e dëbo se ai si hamall
tërë jetën mbi shpinë
të ka mbartur
8.1.08

GJUHË EZOPIKE

Ata ishin Varu Bidonët
me Mos e Çaj Kokën kaluan
tutje. Te rruga që ia Hëngri
Kokën u pa i vdekuri i parë
që Mos o Zot s'e Hanin as
Qentë. Dhe rruga mbeti e
shkretë t'i Fusje Gishtat në
Sy si një pafundësi që po
çliruhej prej detyrimit
për ta përshkuar. Ata e patën
shkruar emrin në Trimi
që s'ia Ha Qeni Shkopin por
siç ndodh me aventurën
e Rasputinit shkoi për
Dhjamë Qeni
11.11.06

E QESHURA ZBAVITËSE

E hidhura nën qiellzë
u bë e tëra lajm që shpërbën
qumështin e gjirit të nënës
Do t'i jap dhe këshillën
e fundit para se të pijë
helmin me rrezikshmëri
shoqërore. Fruti hahet i
gjallë nga pema dhe çdo lloj
industrie që pastron
opinionet rrit dozat e
helmit. E qeshura zbavitëse
është detyruar më parë të
rrezohet tragjikisht prej litarit
të cirkut
30.10.06

NËN KUPOLË TË RESË ATOMIKE

Plumbi i djeshëm po vret
të sotmen siç e shoh në
shenjë jam unë ku më
qëlluan pasi më veshën
me rrobe të bukura. Në ç'vit
do të mbërrinte plumbi kjo
varej nga çasti ku ndaheshin
dy epokat dhe në vend të
gjuhës mendimi po shkruhej
me algjebër dhe formulat e
Ajnshtajnit që tha se ne
shtëpinë do ta kishim më vonë
nën kupolën e resë atomike

30.10.16

SHNDËRRIMI I MADH

E shoh si vjen nata. Llamba
e ditës fiket ngadalë dhe për
kujtesë si një lloj pavdekësie vjen
muzgu. Atje përherë e më
shpesh njerëz të urtë çmenden e
nxjerrin thikat e therin
gjakësisht diellin. Hakmarrje
e lashtë që lanë duart në
gjakun e viktimës. Nata më pas
bëhet gjë e menduar rrit me
shpejtësi qimet si bimë në faqe
e pyllëzohet natyra
në mbrëmje prej fjalëve të urta
12.10.06

NË ISHULL

Në një ishull do më çahet si
shegë zemra në aq kokrra sa e
shkoqëm shegën është tërë bota e
ëndrrave në një frut e
mbledhur. Do më pëlcas vetmia
me gulshe gjaku preh fytit
sepse kur s'më duhen më
duart në të kam provuar të
krijoj një njeri tjetër. Në
ishull ku shfryhen tërë kamardaret
e shpëtimit të pëlcet si fryt
i shegës së pjekur në aq njerëz
sa kishe ëndërruar të jetonin
brenda teje
1.6.07

1991

Vë re një tendencë për të
ikur nga qendra ku fanfarat
më tregojnë rrugën prej ku
duhet ikur sepse sheshi
Skënderbej u mbush plot me
të lumtur. Unë u shmanga
te Shallvaret e gjeta në urë gati
që priste mua para se të
rrëzohej. Lemeria e
frikës e kish çuar turmën
në qendër ku i priste
rregulli dhe paqja dhe
pastrueset jevga që po
na fshinin si bukëshkalë
me fshesë të gjithëve
5.6.07

MORALI

Dhe më në fund ajo duhej të dilte. Nuk i bënte mirë për shëndetin po të mos shfaqej tek ishte aq e bukur lakuriqe e zhveshur e pafajshme ku ne lagnim buzët te burimi. Na pa morali që tani ishte fshehur dhe thoshte: Ah të isha dhe unë aq i lirë që po plakem një shekull pas shkures i fshehur

5.6.07

DURO KUJTESË DHIMBJEN TIME

Kur shënoj datën
kam ngulur një gozhdë
te kujtesa. Një muze u mbushë
me gjëra të vjetra. Thellë koridoreve
të heshtur gjarpërinj që nxitojnë
labirinteve. Tmerre që na dogjën
dikur rrobet e trupit dhe një gjak
i tharë me ADN - në e saj të
të lindjes në faqe të një
libri. Topa 122 m/m tashmë të
shkrirë- skelete përbindshish.
Dhe sa shumë çaste urie që
shkulnin rrënjët. T'i skedonin
por zonja që mba çelësat prej
kohësh ka vdekur. Porta të blinduara
që ndoshta më kurrë s'do
të hapen. Për kujtesën s'ka
përftyrim tjetër. Vij prej
metafizikës në krah të një
ëndrre. I lodhur në kërkim
i ngarkuar me të tëra
humbjet
31.3.19

RRUGICË E MBYLLUR

I vozita tërë rrugët
që dikur më kishin ngrënë
këpucët. Po e çoja fëmijërinë
ku kish qënë të më
gjente një të humbur
Një rrugicë që mbyllte rrugën
e plakur e po i binin qerpiçët
si dhëmbët e prishur të
gjyshes
29.5.05

FËMIJTË

E brejtën dhe hekurin
e zhvendosën edhe
botën. Mëshira s'kishte lindur
akoma që të qanin për fajin
e kryer. Kur e njohën gjithçka
përreth ranë në mendime
dhe nisën të rriten
Motorët u shuan dhe ra
një shi i butë nga qielli
Mendja si një vetëtimë
i përshkoi në thellësi gjërat
Dhe thanë të penduar:
Si ta rregullojmë tani
tërë këtë botë të prishur
17.10.05

KANDINSKI

Ato lexojnë dhe unë pas
pak do të shoh ngjyrën që
do marrin lotët. Kandinski
ngjyen penelin në çast të
dështimit. Kornizën
e vet secila prej grave po
e mbyll në zarf. Ja ku u
duk atje ajo që kish rënë
prej fytyrës së tyre të plakur
Po u kthehet e drejta e
humbur që përleshej me
dhimbjen dhe kavaletat
e zbrazura ngre piktori në sup
dhe gratë i la të lira
të iknin
18.10.05

RRITJE

Ca karikatura të vogla
të një jete të lodhur shoh
si kërcejnë duke fryrë
muskujt nën hijen e një
koke të vogël ata janë
duke qeshur me veten për
shkak se po jetojnë nëpër
forma të tjera të përkulura
duke u ndërruar
pjesëve vendin për t'i dhënë
përparësi zhurmave në
vend të heshtjes

4.10.05

CUNAMI ME EMRIN IRENË

Sa zgjat koha e një kënaqësie dhe
pse të dënuarit tanë po e vjellin. Asaj
që nuk iu dëgjua lutja dhe
koha iku pa e pritur
Hedonistët e gjorë vdiqën prej
ngopjes dhe nuk kish tjetër
zgjidhje receta e Epikurit. Të devotshmit
u dehën dhe nuk e panë botën
si u mbyt në gotën e zbrazur
nëpër reflekset e qelqit. Deti
na dehu me valë të buta
dhe qiell i pafund të kaltër
mbi vete. Para se të vijë
cunami me emrin e bukur
Irena kanë mbetur
aq pak të gjallë për të varrosur
atë shumë të vdekurish

7.9.19

PUSHTUES TË RINJ

Atje ku je mbijnë pemë dhe një lumë të ndan me bregun tjetër. Nuk e mat largësinë e çdo gjëje nga vetja. Je i rrethuar me diçka të pamatshme dhe të panjohur. Kë ke më afër i çon kujtim një tjetri se një pelegrin këtu po bëhet banor i përhershëm. Zogjtë mbi pemë dhe një ujk që ulërin natën. Andej nga vjen frika ti ve një pushkë te gardhi që qëllon natën frikën. Je i rrethuar në një perimetër pa u bërë ende qendër dhe të zbulosh shtegun e erërave. Me farërat e mbetura nëpër plepa jeshillëkun e shijes tënde do të mbjellin. Sa të miqësohesh me dhelprat pleksin ulërimat e tyre me fërshëllimën tënde të një kënge të vjetër. Ti nuk je ende banor me leje për të ndërtuar këtu të ardhmen. Kur të vijnë drerët te gardhi si banor i pyllit

kërkoju leje ndërtimi duke mbajtur mbi
supe një ketër. Merrë me vete
dëshmi njohjeje dhe tregoju
gjer përtej bregut
perspektivën
të qytetit të nesërm
29.9.19

ERA MERR GJETHET ME VETE

Një e shkuar ka auerolën e
e harresës. Kur hesht era atëherë
zbulojmë sa gjethe ka
marrë me vete. E shkuara stoliset
me rroba të reja të stilit
të vjetër. Ne kemi të drejt
të hapim një herë në mot atë që
e kemi mbyllur me çelës. Çfarë
është ajo që hyjnizon veten shpërthen
në aroma që sjellin kohë dhe vende
të lashta. Ajo që dhe pa e prekur
dërgon sinjale gjithëkund auerolën
e saj prej harresës të shpëtoj
nga vdekja kujtesën
28.9.19

AJËR I LIRË

Poezia është ajri- fryma
e natyrës. Gjethet që tunden
e bëjnë ajrin të
tejdukshëm. Pemë që kalben
si mërzi e shkretëtirës.
Ata që ajrin e dogjën
në flakë të barutit.
Tokë e mbetur pa frymë
në Çernobyl për ditë
është duke vdekur. S'ka
shpëtim tjetër veç ta ushqejmë
me qumështin e gjirit. Të
nxjerrim një nga një rrënjët
e kimit. Vetëm poezia e
pa këtë tokë duke vdekur. Ajri
që vjen i lirë këtu shndërrohet
në kufoma njëherësh
12.6.18

TË RRAHURAT E GABIMIT

Një moshë e moçme
gabon më pak duke
ndrequr gabimet e
së shkuarës. Kujton të rrahurat
e gabimeve. Kur vjen një
moshë qiejt lart bëhen
më të ulët i rritin peshat
mbi supe dhe duhen
ngushëlluar shumë të
vërteta të hidhura. Është
pothuaj natë tek ndien
çastin që po bëhet
i tëri i shkuar
12.6.18

NJERËZ TË EGËR

Atje pash njerëz të
çmendur në liri që nuk
pyesnin fare për realitetin.
U hodha litar për tu
kapur por ata u bënë
edhe më të egër. Nuk kapa
dot peng asnjërin prej tyre
dhe s'munda t'i dëboja
dot prej Republikës sime. Ata
ulërinin në ekstazë duke
u tallur me realitetin që po
u shqyente portat
me levën e arsyës
12.6.18

LOJËRA TRAGJIKE

Atje ku loja luhet
në majën e saj shohim
gabimet. Por s'ka kohë për
t'i ndrequr edhe pse si
rrufe shpërthyen ulërimat
Atje është loja ku ndoshta
asnjëherë nuk kanë lozur
këmbët para se në skenë
lojtarë dhe spektatorë figurantë
si plastelinë u shtypën
dhe lojërat u humbën
një natë më parë dhe Çezari
nga pushteti zbriti i
zhytur në gjak si njeriu
i vitit që ulërimën dot
nuk ia nxorrën me thikën
pas shpine
12.6.18

HESHTJA NË PARK

Të heshtur dhe secili na përgjigjet
me shenja. E ruajnë përvojën
nga zhurmat. I bëjnë
shumë pyetje vetes për t'i
dhënë leje kohës të
hyjë brenda. Është çasti kur
përpunohen përvojat në parqe
në shëtitje të gjejnë ekuilibrin
mes flladit dhe mërmërimave
të lutjes. Sa të gjejnë një pikë
ku të mbështeten. Vetëm ata dëgjojnë
si përplasen përrenjtë
ku Herakliti zbuloi orët
e kohës së humbur. E lash
kopshtin në gjumë dhe nëpër
shkallë u ngjita të bëj llogarinë
me kohën ku përtej gardhit
të kopshtit nis një
jetë tjetër. Do pastroj
regjistrin e rëndë për të
qënë i kthjelltë për

Lutjen e Mëngjesit. Kopshti
ishte parajsja por porta
pas meje u mbyll dhe
unë u ngjita lart
të gdhihem i pastër
për Lutjen e Mëngjesit
14.6.18

LËKURA E FJALËVE

Çfarë të bësh me sjelljen
e prishur në rrugë që
përdorë kaq shumë fjalë
të pista dhe ne për lehtësi
më parë mallkojmë gjuhën
që i kishte shpikur. Ka
shumë të përdala që
zbrazen te udha prostituta
lypësa klloun dhe nuk
mungojnë as fantazmat që
shfaqen përherë aty ku
mbaron udha. Sjellja në
udhë çliron prej frymës
gazrat e këqija qëron zhargonin
e fjalëve përzier me të
lehurat e qenve
16.6.18

KUNDËRHELMI

Ata që e panë thanë se
helmi bie në stomak
dhe më në thellësi nis
një kryngritje. Një monstër
e vogël që na tregon
shkakun e prishjes së
humorit. Një pikë helmi
është e nevojshme për tu
krijuar përvoja. Nuk mund
t'i pime dot si ilaçe tërë
bimët e egra. Dikush
më parë prej helmit të fuqishëm
ka vdekur për të shpikur
më vonë si arsye
kundërhelmin
17.6.18

SIZIFË TË NJË KOHE TJETËR

Tani ka një Sizif tjetër më
të arsyeshëm. Nuk e sheh më
majën sipër. Më mirë e mba
malin mbi shpinë se
majës t'i ngjitet. Vetëm eshtrat
i kanë mbetur dhe miti i
lashtë tani qan për
Sizifin. Jetën që i ka mbetur
e sheh te maja si flamur
të grisur. Me kaq shumë
gurë mbi shpinë rrokullisur
edhe paqja u bë më e urtë
tek qëron prej morrave
trupin. Everestianët e
fundit po kthehen prej frikës
mos i ze gjumi në majë
dhe si gurë më vonë
do të rrokullisen

19.6.18

DIAGRAMË

Vijat s'më tregojnë
nëse është më afër. Te kujtesa
kurba ulet e ngrihet. Kthehem
pa dashur aty ku isha dje
por më tepër kam fluturuar
për t'i kapur prej magjisë
nëpër përvjetore vdekjesh
2500 vjet Thermopile por
besoj vetëm si rastësi vdekjen. Ka
një të shkuar fare të afërt që
po më ushqen ende Frymën
dhe nuk po gjej dot çelësin
ku harresa e ka fshehur
Treqind ishin ata të
Thermopileve që tani i bënë
këtë nder kujtesës sime
20.9.18

AJO QË PËRHERË ËSHTË DUKE ARDHUR

Fëmijëria është kohë e
shkurtër. Përherë është duke
ardhur prej një pafundësie
si të jetë e jetuar në
një planet tjetër. Gjer
më tani asnjë plumb i
marrë s' e ka vrarë ende edhe
pse ka qënë përherë në
shënjestër. Ajo që ka frymën e
luleve dhe të qumështit të
gjirit i jepë jetë ende
një trupi të plakur. Ajo
që kurrë nuk e njohu frikën
dhe u pa me guxim
si te pasqyra po rritej
20.9.18

NË GJYQIN E SË ARDHMES

Të pyes ti që duke ikur
po tërheq kohën mbrapa. Çfarë
tjetër di të bësh me kohën. Kur
solucioni i kohës në mendje
është prishur. Është po ajo që
do na thërras në gjyq në të
ardhmen. Si u sollët me mua
kur unë një mijë vjet
u kisha pritur. Pyes veten:
me të çdo të bëhet në të
shkuarën time. Shumica e
saj tashmë është e braktisur
dhe sëmundje e ligë i bëhet
së ardhmes kjo kohë e humbur
22.9.18

BALONAT NË ZEMËR

Është muri me dritare
si sy që i hap e i mbyll
natën. Kur mbyllem te
vetja ulërijnë erërat e
rreh shiu dritaren. Kur hapi
një zemër mjeku gjeti një kuti
të artë fshehur. Ato që më
vonë do të iknin si flutura
Muri i zemrës qe thyer dhe
mjeku la aty një balonë
të vogël të dilnin një nga një
fluturat prej zemrës
së shqyer
25.9.18

PËRRALLA ME UJQËR E KECA

Nuk kam parë as ujk as
çakall nga afër. Vetëm prej
përfytyrimit lindet përralla e
ujkut. Sikur t' i kisha
parë nga afër do ta
kisha njohur dhe frikën. As
kthetra nuk pamë. Kur i
mprehnin te kockat dhëmbët
na kishte dalë krejt frika. Duhet
të të kafshojë ujku dhe të
shohim urinë në sytë e tij që
të na verbojnë dritat. Ja pse
tani nëpër përralla shëtit
i qetë ujku dhe çakalli i vogël
atje ku zhvendosëm më larg pyjet
të mbrojmë qytetërimin

25.9.18

ALKIMISTI

E jotja është ajo që e bujte
një natë në errësirën tënde. Për
tu lindur prej saj diçka tjetër
dhe mua alkimistin e vjetër
që njëlloj e ke dënuar me vdekje
për të mos e braktisur
I shtove vetes diçka
më të bukur për ta rritur
në errësirë sepse dritën e
diellit e fik dhe njëra e
vogël sa gjysma e qytetit
një pjesë e trurit tënd
lutet të dalë nga errësira dhe
gjysma në hemisferën tjetër
bën roje për të ruajtur
misterin
26.9.18

NË TREG

Në treg jemi të gjithë për tu shitur. Arenë ku secili ka atë që nuk e zotëron tjetri. Po këmbehen ndërsa po e thyejnë atë që shesin të zbukurojnë njëra-tjetrën. Japin atë që e kanë tepër. Dhe çfarë do ndodhë më vonë kur të jenë blerë tërë të shiturat. Vlera rritet te humbja dhe zotërit e fitores prej mërzisë atë që fituan si kripë me një çmim shumë herë më të vogël do ta shesin

28.9.18

RITËM SHIU

Bie shi por jo kushdo e
dëgjon atë si muzikë. Natyra
ujit rrënjët e saj dhe
ne s'ishim të gjithë në pritje
të dhuratave që po binin
nga qielli. Shi që ngre
ritmin ndërsa po gjëmojnë
daullet. Gjersa në ballkon
spektatorë të trembur
hynë brenda të marrë në
shenjë prej vetëtimave. Natyra
u shpreh me egërsi për të
trembur shkretëtirën. Natyra
u shpreh por në shesh s'ka
më vorbulla për tu
mbytur nga shiu
30.9.18

BETOHEM

Kur nënshkruaj i jam
dorëzuar së vërtetës. Për
të ruajtur gjuhën mos i
futet ndonjë fjalë e huaj
vjedhurazi. Për ç'kemi
thënë është mirë të
paraqitemi te gjyqi i
ndërgjegjes ku prej së shkuarës
përherë do të ketë plehra
të mbeturash. BetoheM për
të vërtetën dhe kur të më
djegin sërish në turrën
e druve inkuizitorët të
mbyllur në burgun
e vetes
5.10.18

TURMA NJË-KËMBËSHE

Askush s'të ndalon të bëhesh i
verbër duke vrapuar drejt dritës
sime. Secili zgjedh shtegun e vet
të hollë sa masa e këmbës për
të gjetur udhën. Ja pse rrallë
gjen gjak të përbashkët dhe sozi
që ndërrojnë fytyrat e njëri-tjetrit.
Po të le një mundësi
te kthesa të më tejkalosh
mua- tha njeriu i lodhur
nga lavdia. Jemi në një
garë të heshtur për të dalë para
prijësit edhe kur shtypemi
nga këmbët e turmës
19.10.18

LEXIM I VËSHTIRË

Heshtja e njeriut – lexim
i vështirë. Unë po shkoj në
laborator të identifikoj
shenjat. E kam edhe më të
rëndë rëndesën e një mali
të tërë mbi vete. Dhe çfarë
është heshtja që çon mesazhe
të padeshifrueshme. Për t’i lexuar
le të bëjmë tani secili
autopsinë e mendjes. O heshtje
tinzare një mal i tërë me
fjalë që po blihen prej njëra-
tjetrës me kaq pak fakte
brenda të zbulojmë se çfarë
ti thellë vetes
kishe fshehur
4.11.18

MEGJITHATË....

Megjithatë.....është një fjalë
që ngec nëpër kockat e
holla të gjuhës. Sa e rëndë
pesha e saj kur nuk e
dimë ç'fjalë tjetër është
duke pritur. Ngarkesa
të rënda që presin të
shkarkohen me plot të
mbytur ose të mbytur që
prekin bregun të lumtur. Fjala
na lutet të mos nxitojmë
as të ndezim qirinjtë as të
valvisim flamurët. Ka një
sublimitet siç është vet çasti
te koha për të kuptuar se
çfarë na bënë dhuratë e
shkuara dhe çfarë prej saj
me solemnitet tani duhet
ta varrosim

4.11.18

TOKË EDHE QIELL

Që kur vatrën e braktisën
zjarri në të më nuk
është ndezur. Fytyra pa faj që
zhveshin këmishat prej
plumbit për të pritur
plumbat. Që kur ikën koha
para Erës së Re ishte. Siç
bëhet lartësi çasti- çasti
që e kish vrarë në mitër
kujtesën. Vatër që s'ka prekur
kurrë kohë të mëpastajme
sepse prej hirit
dhe flakës nuk u bënë
kurrë dot më bashkë tokë
edhe qiell

2.11.18

ZJARRI DHE HIRI

Ndërsa po ikën me
tymin e saj gjithçka
po digjet. Ne thamë: e
gjallë vetëm fryma do
të mbetet. Zjarri e ktheu
në asgjë atë që prej tij
kishte lindur. La si dëshmi
vetëm hirin. Me tymin sipër
është përjetësia e kujtesës
Ajo po zgjedh çfarë
prej saj si dëshmi te hiri
do të mbetet

1.10.18

ZOTI I PËRFYTYRIMIT

Ja një njeri duke parë
zotin. Zoti i përfytyrimit
po zbret nëpër shkallët e
reve. Dhe unë pash
Njeriun jo Zotin e tij
që si shpend i plagosur
përplaste kokën para sheshit
të kishës. Dhe çfarë
imagjinate si u bashkuan
në një tokë edhe qiell. Njeriu
ka qënë kjo dhimbje e
madhe prej rënies që nuk e
kish gjetur dot zotin e
vet në qiell
30.10.18

FJALA ËSHTË ZOTI

Fjala nuk bën zhurmë mbi
letër as vet fjala që brenda
vetes po shkruhet
Të lidhur me
pranga demonët te dhëmbët
dhe në surdinë dëgjoen
psherëtimat. Fjala është
zoti dhe letra si femër
epshit të saj i bindet. Prej
shumë lart po vijnë fjalët
gjersa mbi letër shërohen e
plagët qajnë psherëtimat
30 10 18

ROJET E FRIKËS

Pastaj bëhet krejt natë.
Errësirë që e shpleksim për tek
vetja me fillin e dritës. U shuan
dhe yjet dhe qirinjtë dhe u bë prapë
natë. Është çasti kur po
zgjohen përbindshat. Mos u
trembni prej tyre. Ata që u
u bënë roje të frikës sime
po t'ua zbërthejmë gjuhën
bëhen bashkëbisedues
të shkëlqyer. Nata është duke
gërmuar për të nxjerrë në
sipërfaqe dritën. Vetëm ta
besosh qoftë edhe për të
Kremten e Ringjalljes ke për
të parë vetëm të përflaken
prej agut dhe ti nxito
për tu bërë zjarrfikës
29.6.18

SHPIRTI I SHKRETËTIRËS

Siç thotë Amos Oz shkretëtira
natën mbërdhi. Porta
e shtëpisë së tij hap e
mbyll shkretëtirën. Njeriu
që e zhveshi harroi
ta mbulonte natën
përsipër. Amos Oz duke
dalë natën ndien një
frymëmarrje- gulçonte
vet rëra duke
si thëngjij të fikur. Ishte gjallë
ende shpirti i
shkretëtirës
3.7.18

GJAKU I FJALËVE

Ia hodha fatin dorës së
djathtë- pash përrenjë të
tharë dhe pyeta fatin ku
ka shkuar gjaku në damarët
Dora e djathtë e lodhur nga
shkrimet më tha: gjakun
do ta gjesh te fjalët e
shkruara. Hidhe fatin te
dora tjetër të gjesh ca kocka
të vogla mbetur prej
luftës me kuçedrën
4.7.18

NË KOQINO MILO

Ç'mendje e çmendur
e bëri qytetin varrezë
të bukur për të gjallët
hapi shtigje nga të
katër anët të hynin
pa paguar më parë as
taksën e qytetërimit. Tani
jetojnë të gjithë në trupin
e një përbindshi ku mes
shumë luleve e bletëve
merr frymë njeriu. Në Koqino
Milo 1/ një ditë prilli pashë
si u zgjuan të vdekurit të
sapovdekurin e ri me
lule në duar ta prisnin
1/ Varrezë publike në një nga
lagjet e Athinës
6.7.18

GËRMADHË E BUKUR

Sa shumë gërmadha. Mbyll
sytë prej tymit dhe hundët
prej asaj që ende po digjet
Kjo e sotme që përherë do
të jetë duke çelur prej
gërmadhëve të së shkuarës
Dhe kjo që në një ardhme të largët
do kundrohet më vonë
si gërmadhë e bukur. Kështu
do të rilindin të ardhmet kur
prej kësaj së
sotme do të jenë
shndërruar në pluhur
20.7.18

OPIUM

Po të tregoj një shkak
ku një çast në jetën
time ma bënë të përgjeshme
gjithçka që e prekja
me duar. Shkaku i paçmuar
u gjend te humbjet e mia. Si
u mbush papritur me
lumturi jeta dhe zbulova
këmbët e një lejleku te
krahët e tij fshehur. Ishte
vetëm një çast që si kujtim
më vonë do shëronte
me opium tërë dhimbjet
20.7.18

NËPËR STINË

Përvoja para se të më
shpaloset si cohë e
kuqe. Unë akoma s'kam
trokitur tek e Shkuara që
e kisha lënë në gjumë
para dy shekujsh. Ajo
fuqi tek vetja që duhej
mundur tani është në
duel me cohën e kuqe
ose brirët e demave do
ta grisnin dhe simbolet
m'i shuan krejt dritat në
mendje. Me përvojën
time unë tani jam krejt
vetëm dhe prej saj
po kthehen të ngopur dhe
viktimat që nëpër stinë
nuk do vjellin më dot
përvoja të vdekura

NË UDHËKRYQ

Për diçka tjetër u bë gati
qielli dhe në trafik po përplasen
erërat. Vetëm çështje kohe
sa të nis shiu. Të shtyjë
fluturimet. Semaforët tregojnë
udhë që s'kanë liri për të
ecur. Çaste kur mendja jonë
përpiqet të kap shpejtësinë e
erërave. Për arsye të qiellit
të mbyllur u bë më e mbyllur
mendja ime. Prej fluturimit
pa adresa të zogjve në qiej. Ka
shumë flamuj por s'dihet cili prej tyre
pak më vonë do të
ulet në gjysmështize
23.1018

